

SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE TERMAT E REFERENCES

Operatorët ekonomik duhet ti referohen v.k.m nr.438,datë.08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”,si dhe Udhezimit nr 2 datë.03.03.2017 “ Per kerkesat teknike te caktimit te ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore per trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat per vjeljen e materialit drusor me qellim sigurimin e druve te zjarrit per ngrohje.

Skicimet, parametrat teknik etj:

- Gjatësia e druve të jetë sipas standartit shtetëror 95 cm deri 105 cm
- Lartësia e druve të stivosura të jetë sipas Udhezimit nr 2 datë.03.03.2017 “ Per kerkesat teknike te caktimit te ngastrave,grupngastrave dhe ekonomive pyjore per trajtime me prerje rigjeneruese,rregullat per vjeljen e materialit drusor me qellim sigurimin e druve te zjarrit per ngrohje,kreu 8 Depozitimi dhe stivimi i materialit drusor,**pika 2 ,gërma d.**
- Trashësia e seksionit rrethore mesatare sipas projekteve të ngastrave **bashkengjitur dst**
- Të mos ketë dru të kalbura gjatë dorezimit .
- Transporti i largët i tyre nga venddepozitimi i caktuar i parcelave deri në fushën e Bashkisë Kolonjë,Qyteti Ersekë ,duke bërë te mundshme matjen e volumit të mallit nga blerësi.
- Malli do të bëhet hyrje kur pritesit e mallit,në institucion , të shprehin dakortësinë për cilësinë dhe sasinë e mallit.
- Shërbimi do të bëhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor për kohën dhe sasinë , brenda kohës së përfundimit të kontratës.

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

NR	EMERTIMI	Ekonomia Pyjore	Njesia	Sasia
Shfrytëzimi i materialit drusor të pyjeve shtetëror në Bashkinë Kolonjë,viti 2023				
1	Prerje e materialit drusor në këmbë (të paprerë) dhe transporti i largët i tyre nga venddepozitimi i caktuar i parcelave deri në fushën e Bashkisë Kolonjë ,Qyteti Ersekë .	Parcela nr 51/a, të ekonomisë pyjore Orgockë.	m3	971
1	Prerje e materialit drusor në këmbë (të paprerë) dhe transporti i largët i tyre nga venddepozitimi i caktuar i parcelave deri në fushën e Bashkisë Kolonjë ,Qyteti Ersekë .	Parcela nr 54/a të ekonomisë pyjore Orgockë.	m3	513
	TOTALI		m3	1484

Shënim:Për efekt të depozitimit dhe stivimit materialit drusor do të llogaritet sipas formulës
1484 m3 * 1.667 =2,474 m/stere

Afatet e ekzekutimit:

Bazuar në v.k.m nr.438,datë.08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”,kreu III pika 5, periudha e prerjes së materialit drusor në kembe (të paprere) përfundon në **30 shtator të vitit 2024** , si dhe Udhezimit nr 2 datë.03.03.2017 “ Per kerkesat teknike te caktimit te ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore per trajtime me prerje rigjeneruese,rregullat per vjeljen e materialit drusor me qellim sigurimin e druve te zjarrit per ngrohje “ , **kreu IV Prerja dhe asortimi,pika 1.**

Ndërsa ,

Transporti i largët i tyre nga venddepozitimi i caktuar i parcelave deri në fushën e Bashkisë,Qyteti Ersekë do jetë data **31 Dhjetor 2024.**

Komisionit të Përgatitjes së specifikimeve teknike dhe termave të referencave .